

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) zhvillon pas rreth 8 muajsh seanca dëgjimore me gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda, kandidatë për në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

- *Për 4 gjyqtarë të Gjykatave të Krimeve të Rënda, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë vendimin e formës së prerë: Ndërkohë që 3 subjekte janë konfirmuar në detyrë, KPK ka shkarkuar gjatë muajit prill Kryetarin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda*

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit zhvilloi në datat [2](#) dhe [4](#) prill seancat dëgjimore me 2 gjyqtarë të Gjykatave të Krimeve të Rënda, njëri prej të cilëve [Kryetari](#) i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Seancat e fundit dëgjimore për gjyqtarë pranë Gjykatave të Krimeve të Rënda janë zhvilluar gjatë muajit [korrik 2018](#) dhe pas rreth 8 muajsh KPK riktheu në kalendarin e aktiviteteve zhvillimin e seancave dëgjimore me gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda, për të cilët procedurat e rivlerësimit kanë filluar me shortet e muajve [maj 2018](#) dhe [janar 2019](#).

Siç është [shtjelluar](#) edhe më parë, konfirmimi në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda është i detyrueshëm për emërimin e tyre të përhershëm në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përveç këtij detyrimi ligjor, për emërimin e përhershëm të tyre, gjyqtarët duhet të plotësojnë kriteret për ngritje në detyrë të parashikuara nga legjislacioni respektiv si edhe së bashku me familjarët e afërm të tyre të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Aktualisht, Gjykatat e Krimeve të Rënda vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi [deri në ngritjen dhe funksionimin](#) e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, deri tani nuk ka një konfirmim apo njoftim zyrtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor sa i përket emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme. Për rrjedhojë, nuk ka ende informacion mbi numrin e gjyqtarëve të këtyre gjykatave, të cilët kanë pranuar kushtet për kufizimin e privatësisë apo atyre gjyqtarëve, të cilët nuk kanë pranuar të nënshkruajnë deklaratat lidhur me kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.


Fillimi i procesit të rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda dhe përfshirja e tyre në kalendarin e seancave të fundit dëgjimore ndikon në avancimin e procesit të rivlerësimit për këto gjyqtarë. Duke ju referuar ritmeve të deritanishme të vetting-ut në drejtim të gjyqtarëve të Krimeve të Rënda, pengesa apo sfida të mundshme të procesit mund

të vinë si rezultat i mos konfirmimeve dhe numrit të ankimimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA).

Në këtë kontekst, edhe pse për vetëm 4 gjyqtarë të Gjykatave të Krimeve të Rënda është dhënë tashmë vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, 1 prej tyre është zgjedhur [anëtar](#) në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke u përjashtuar nga gara për gjyqtar në Gjykatat KKKO. Ndërkohë për 1 gjyqtare të [konfirmuar](#) nga KPK që në muajin korrik 2018 ende [nuk është dhënë](#) një vendim përfundimtar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Nga ana tjetër, [shkarkimi](#) i Kryetarit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda shënon një hap negativ në pritshmëritë ndaj numrit të konfirmimeve në detyrë.

Në kushtet kur, Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë parashikuar të përbëhen nga 16 gjyqtarë në Shkallën e Parë dhe 11 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit dhe kur kandidatët e parë potencialë për të kaluar në këto gjykata janë gjyqtarët aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda, ritmet e deritanishme mund të ndikojnë në disfavor të ecurisë normale në kohë si edhe plotësimit në numër sa i përket emërimeve të përhershme të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme. Kjo e fundit do të ndikojë edhe në ushtrimin sa më funksional të veprimtarisë së këtyre organeve me rol thelbësor në gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në të njëjtën kohë, transparenca e organeve përgjegjëse siç është Këshilli i Lartë Gjyqësor në drejtim të informimit mbi ecurinë e emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme KKKO apo rivlerësimin me përparësi të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda, mbeten një faktor i rëndësishëm në drejtim të mirëinformimit mbi ecurinë e procesit si edhe ndërgjegjësimin të publikut mbi nevojën për zatimin e harmonizuar të hapave ligjorë për ngritjen e institucioneve të gjykimin dhe hetimit kundër veprave të korrupsionit dhe krimit të organizuar.



Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”: Vlerësimi/përzgjedhja e kandidatëve prokurorë dhe ngritja në detyrë në Prokurorinë e Posaçme

- *Përfundon verifikimi i plotësisht të kushteve ligjore për 28 kandidatët për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (PP): 25 subjekte aplikantë për 15 vendet vakante në PP do të vazhdojnë garën për ngritje në detyrë në institucionin kryesor të hetimit*

Pas [miratimit](#) nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Rregullorja hyri në fuqi me [botimin](#) në fletoren zyrtare të datës 29 mars 2019. Ky dokument do të shërbejë për të përcaktuar kriteret dhe procedurat për ngritjen në detyrë të prokurorëve kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme, duke synuar realizimin e një procesi objektiv, transparent dhe gjithëpërfshirës. Ndër të tjera, Rregullorja thekson rëndësinë e krijimit të një Prokurorie të Posaçme të aftë për të ushtruar funksionet e saj në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe efektive.

[Komisioni i Posaçëm](#) i ngritur sipas parashikimeve të Rregullores nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë përfundoi procesin e shqyrtimit paraprak lidhur me plotësimin e kushteve ligjore për [28 kandidatë](#), të cilët shprehën interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Në [seancën plenare të dates 5 prill](#), pas prezantimit të relacionit përkatës nga Kryetari i Komisionit të Posaçëm, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë votuan unanimisht miratimin e [listës](#) me 25 emrat e kandidatëve për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilët plotësonin kushtet ligjore, duke vendosur [skualifikimin e 3 aplikantëve të tjerë](#). 25 kandidatët e kualifikuar do të nënshtrohen një vlerësimi të hollësishtëm nga 5 anëtarët e Komisionit të Posaçëm.

- *Kriteret dhe shkallët e vlerësimit për 25 kandidatët në garë për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme: Kriteri i vlerësimit të performancës dhe kriteret e posaçme etike dhe profesionale për ngritjen në detyrë si prokurorë i posaçëm*

Komisioni i Posaçëm, i cili ka filluar tashmë nga puna për shqyrtimin e dosjeve të 25 kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, do të bazohet në vlerësimin e dy kriterëve kryesorë, për të cilat është parashikuar të aplikohet një sistem pikëzimi.

1. Kriteri i vlerësimit të performancës
 - (rezultatet për vlerësimet e dy viteve të fundit);
2. Kriteret e posaçme etike dhe profesionale
 - Aftësitë e treguara në hetim, në ndjekjen penale dhe në konfiskim;
 - Vendosmëria e treguar në përballimin e vështirësive, presioneve e rreziqeve dhe integriteti.

Për të dyja këto kritere, Rregullorja specifikon në mënyrë të detajuar indikatorë specifikë, të cilët janë paraqitur në mënyrë të hollësishme dhe të përmbledhur edhe në [Raportin e II të Monitorimit](#) “Mbi ecurinë e procesit të emërimit të Gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar”.

Rregullorja parashikon gjithashtu afatet kohore në lidhje me përfundimin e procesit të vlerësimit të kandidatëve, i cili është parashikuar të zgjasë 6 javë, specifikisht deri në datën 15 maj 2019. Brenda kësaj periudhe kandidatëve mund tu kërkohen dokumenta shtesë, të cilat duhen të identifikohen dhe paraqiten tek Komisioni i Posaçëm brenda një afati 7 ditor. Pas kësaj faze, për vlerësimin e kandidatëve do të zhvillohet edhe një proces 2-javor intervistimi, i cili përfshin edhe pyetje të drejtuara nga përfaqësues të misioneve ndërkombëtare EURALIUS dhe OPDAT.

Pas përfundimit të këtyre fazave, Kryetari i Komisionit të Posaçëm njofton Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe vendos në dispozicion të anëtarëve kopje të vlerësimeve të shkruara, dokumentet mbështetëse si edhe prezanton një përmbledhje të rezultateve të vlerësimit. Bazuar në këto propozime, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi përgjegjës për të vendosur shkallën e vlerësimit për secilin kandidat dhe secilin kriter. Pas vendosjes së shkallës së vlerësimit për secilin kandidat dhe pikëve për secilin prej kritereve (sipas hapësirës së pikëzimit), kandidatët renditen sipas numrit të pikëve që ato kanë grumbulluar.

Ndërkohë emërimi përfundimtar i kandidatëve (ngritja në detyrë) kryhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë vetëm pasi ato të kenë kaluar procesin e rivlerësimit dhe të jenë konfirmuar në detyrë. KPK dhe KPA pritet të përshpejtojnë gjatë kësaj periudhe procedurat e rivlerësimit për këto prokurorë. Krijimi i Prokurorisë së Posaçme shpallet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe më pas prokurorët e ngritur në detyrë kanë mundësinë të aplikojnë për pozicionin e Drejtuesit të institucionit.

- *Krijimi i Prokurorisë së Posaçme: Procedurat dhe zgjedhja e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme*

Momenti i krijimit të Prokurorisë së Posaçme realizohet kur arrihet numri i nevojshëm i prokurorëve të kofirmuar për ngritje në detyrë si prokurorë të posaçëm, të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit duke u konfirmuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Të gjitha ato prokurorë kandidatë për prokurorë të posaçëm, të cilët nuk arrijnë të konfirmohen në detyrë nga KPK, përjashtohen nga kualifikimi për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme. Ndërkohë duhet theksuar që edhe pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme, Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të rihapë thirrjen për aplikime në rast se ka nevojë për më tepër anëtarë. KLP është organi përgjegjës, i cili mbledhet për të vendosur krijimin e Prokurorisë së Posaçme duke koordinuar punën edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Një nga hapat më të rëndësishëm pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme është zgjedhja e drejtuesit të këtij institucioni. Prokurorët e ngritur në detyrë në Prokurorinë e Posaçme mund të shfaqin interesin e tyre për pozicionin e drejtuesit të këtij organi, pas një kërkesë me shkrim dhe plotësimit të standardeve/kërkesave brenda afateve ligjore të përcaktuara në Rregullore. Këshilli i Lartë i Prokurorisë nëpërmjet një votimi të hapur dhe nominal realizon zgjedhjen e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në mbledhjen më të afërt. Ky i fundit luan një rol thelbësor në administrimin e Prokurorisë së Posaçme dhe aspekteve më të rëndësishme të institucionit.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë plotësohet me anëtarin e ri prokuror: Në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë ankimuar edhe vendime ndaj kandidatëve për prokurorë të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

- *Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve zgjedh anëtarin prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP): Me 135 vota pro, prokurori Vatë Staka është anëtar i ri i Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

Me [shkarkimin](#) e anëtares prokurore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në datën 5 mars 2019 Prokuroria e Përgjithshme shpalli [thirrjen](#) për paraqitjen e shprehjes së interesit për kandidatë prokurorë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Thirrja e publikuar në faqen zyrtare të institucionit parashikonte kriteret dhe dorëzimin e dokumentacionit respektiv të prokurorëve nga Prokuroritë e Shkallës së Parë brenda afatit të parashikuar deri në datën 20 mars 2019.

Pas verifikimit për plotësimin e kushteve për anëtarë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme [njoftoi](#) mbi kandidaturën e vetme të prokurorit Vatë Staka (i [konfirmuar](#) në detyrë nga KPK në korrik 2018), i cili për [herë të dytë](#) kandidon për pozicionin e anëtarit prokuror në KLP dhe i cili u rendit gjithashtu si një nga 25 kandidatët për të vazhduar garën për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme.

Prokuroria e Përgjithshme vijoi zbatimin e procedurave të mëtejshme në lidhje me zgjedhjen e anëtarit të ri prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Nëpërmjet një [urdhri të datës 8 prill 2019](#) u miratua fleta tip e votimit për anëtarin prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ndërkohë referuar [njoftimit](#) përkatës të institucionit, në datën 11 prill 2019 u zhvillua Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, e cila pavarësisht [debateve](#) për ndryshimin e mënyrës së votimit, zgjodhi prokurorin Vatë Staka si anëtarin më të ri prokuror të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve, [votuan 216 prokurorë](#), 135 prej të cilëve votuan pro kandidaturës së z. Vatë Staka dhe 81 kundër.

Numri i lartë i ankimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit mbetet një çështje me rëndësi sa i përket funksionimit dhe qendrueshmërisë së institucioneve të reja të drejtësisë gjatë ushtrimit normal të veprimtarisë së tyre. Ende për [3 anëtarë](#) të Këshillit të Lartë të Prokurorisë pritet konfirmimi përfundimtar nga KPA. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë pritet të përfundojnë shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve dhe dokumentacionit për kandidatët për prokurorë të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme. KLP po ushtron aktualisht disa nga kompetencat më të rëndësishme të institucionit dhe për këtë arsye koordinimi i duhur i aspekteve administrative dhe njerëzore mbetet një faktor kyç në realizimin e objektivave, në mënyrë të veçantë në kushtet kur ende për këtë organ mungon akomodimi logjistik.


- Gjysma e vendimeve për kandidatët e kualifikuar për të vazhduar garën për ngritje në detyrë prokurorë në Prokurorinë e Posaçme (të konfirmuar në detyrë nga KPK) është ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (KPA)

Procesi i rivlerësimit është konsideruar në vazhdimësi një nga hallkat më të rëndësishme në drejtim të emërimit të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Tashmë kur Komisioni i Posaçëm i ngritur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka seleksionuar [25 kandidatë](#), të cilët plotësojnë kushtet ligjore për të vazhduar garën për prokurorë të posaçëm, përveç shqyrtimit të dosjeve përkatëse, rregullorja ka parashikuar edhe kërkesën ndaj Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për rivlerësimin me përparësi të atyre prokurorëve, të cilët nuk i janë nënshtruar ende këtij procesi.

Aktualisht, nga 25 prokurorë në garë për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme, vetëm 5 prej tyre janë konfirmuar me vendim të formës së prerë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Siç u përmend në çështjen e trajtuar më lart, zgjedhja e prokurorit Vatë Staka si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pritet të sjellë tërheqjen e tij nga gara për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, duke e çuar në 4 nga 25 numrin e kandidatëve për prokurorë të posaçëm të konfirmuar në detyrë. Për të gjithë kandidatët e tjerë kanë filluar procedurat e rivlerësimit sipas shorteve respektive, ndërkohë që në kuadër të rivlerësimit me përparësi, pritet përfshirja e tyre në kalendarin e seancave dëgjimore.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, në datën 10 prill 2019, institucioni i Komisionerit Publik [ankimoi](#) vendimin e KPK-së për një nga 4 subjektet e konfirmuara në detyrë, kandidatë për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme. Kërkesa i është drejtuar [Kolegjit të Posaçëm të Apelimit](#), i cili do të vendosë gjatë periudhës në vazhdimin mbi konfirmimin përfundimtar të subjektit. Ndërkohë, ende KPA nuk ka dhënë vendimin për një [prokuror tjetër](#) pjesë e subjekteve në garë për prokurorë të posaçëm, duke bërë që gjysma e vendimeve për 4 prokurorët e konfirmuar të ankimohet në KPA në priti të vendimit përfundimtar.

Në kushtet kur numri i prokurorëve kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme të konfirmuar në detyrë nga KPK, por edhe ai i gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda kandidatë për në Gjykatat e Posaçme është ende shumë i ulët, ankimi i vendimeve përbën një sfidë për mbarvajtjen në kohë të procesit si edhe plotësimin e vendeve vakante të kërkuara nga legjislacioni respektiv për ngritjen dhe funksionimin e Gjykatave të Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme.



	Kandidatët e KUALIFIKUAR për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme KKKO		Statusi & Vendimi i KPK *
1.	Altin Dumani	Prokuror/Prokuroria e Apelit Tiranë	Në proces rivlerësimi
2.	Anita Jella	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
3.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme	Konfirmuar
5.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
6.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
7.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Konfirmuar/ANKIMUAR
8.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
9.	Donika Prela	Drejtuese/Prokurorisë së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda	Konfirmuar/ANKIMUAR
10.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
11.	Dritan Prençi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Konfirmuar
12.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
13.	Elida Kaçkini	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
14.	Elizabeta Imeraj	Drejtuese/ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Në proces rivlerësimi
15.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
16.	Enkeleda Millonai	Drejtuese/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Në proces rivlerësimi
17.	Enkeleda Xhengo	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
18.	Eugen Beci	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
19.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
20.	Maksim Sota	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
21.	Manjola Kajana	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
22.	Ndini Tavani	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	Fillon procesi i rivlerësimit (mars 2019)
23.	Shkëlzen Cena	Prokuror/Prokuroria Dibrës	Në proces rivlerësimi
24.	Vatë Staka	Prokuror/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër	Konfirmuar/Zgjedhur anëtar i KLP
25.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces rivlerësimi
	Kandidatët e PËRJASHTUAR për vazhdimin e garës prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme KKKO		
26.	Fatmir Hoxhaj	Drejtor-Drejtorja e Administrimit të Pronës Shtetërore, Ministria e Financave (ish-prokuror)	Kandidat ish-prokuror
27.	Irena Nino (Vujoshi)	Anëtare e perkohshme pranë Komisionit të Monitorimit të Reformës në Drejtësi	Kandidate ish-prokurore
28.	Gëzim Cenaj		Kandidat jo-prokuror

Lista e kandidatëve të kualifikuar dhe përjashtuar për të vazhduar garën për prokurorë pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Burimi: Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), 5 Prill 2019: <http://klp.all/index.php/2019/04/05/vendime-date-05-04-2019/>

* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 16 prill 2019.